

 REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIA PËR KOMBATIMIN E KORRUPSIONIT AGENCY FOR COMBATING CORRUPTION		
Llog. D. p. D. m. DPK/DMP	Nr. K. p. D. m. 03-38.95/12	
Nr. L. p. D. m. 02	Data 30.10.2012	
KOSOVAN		

Nr. Regj.18215/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, gjyqtaria Azra Cakolli me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Dukagjin(Jakup)Zabërgja, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 22.10.2012 morri këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET: Procedura për kundërvajtje ndaj **Dukagjin(Jakup)Zabërgja**, i lindur më 28.10.1968 në Prishtinë, me vendbanim në lagjen "Taslixhe", rruga "Mehmet Akif Ersoi", nr. 36, në Prishtinë, ka kryer fakultetin e mjekësisë, Shef i Divizionit për narkotikë dhe substanca psikotropike, për kundërvajtjen nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, **konform nenit 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak se nuk ka prova se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë.**

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet palës dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-1804/2012 me datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit Dukagjin Zabërgja, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, me të cilën kërkesë i vihet në barrë se në Agjencinë Kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt vjetor të pasurisë deri më datën 31 mars të vitit 2012.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetorë deri më datën 31 mars 2012 pasi që nuk e ka pas këtë obligim duke pas parasysh se më datë 27.0.2012 ka marr Vendimin me numër të protokollit 227, me të cilin ky është kthyer në pozitën e mëparshme dhe se nuk ka qenë më ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit të Licencimit, andaj më datë 31 mars 2012, ky nuk e ka ushtuar këtë detyrë dhe nuk e ka pas obligimin e deklarimin të rregullt vjetor të pasurisë, duke e prezantuar si provë materiale Vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë, nr. 227 të datës 27.02.2012.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtaria ftoi përfaqësuesin e Agjencisë kundër Korrupsion Enis Sadikun, i cili deklaroi se pika kontaktuese nuk i ka lajmëruar për ndryshim e bërë edhe pse ka pas obligim andaj, agjencia nuk e ka pas këtë informatë të cilën tani e kanë verifikuar dhe i njëjti sipas Vendimit nr. 227 të datës 27.02.2012 të cilin e ka prezantuar edhe në gjykatë, nuk ka pas obligim me bërë deklarimin vjetorë të pasurisë, duke pas parasysh se nuk e ka ushtuar detyrën e Drejtorit të Departamentit të Licencimit.

-2-

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi të deklaratës së të pandehurit, deklarata e përfaqësuesit të Agjencisë kundër Korrupsion Enis Sadikut, vlerësimi të shkresave të tjera të lëndës e posaçërisht nga administrimi i provës materiale të prezantuar gjatë seancës gjyqësore Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr. 227 të datë 27.02.2012, në bazë të cilit u vërtetua se më datë 27.02.2012 nuk ka qenë më ushtrues i detyrës së Drejtorit të Departamentit të Licencimit, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri nuk ka kryer kundërvajtjen, andaj në vështrim të nenit 198 par. 1 pika 8 të LK, **pezulloi** procedurën për kundërvajtje në mungesë të provave.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 18215/2012, datë 22.10.2012



KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimi të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.